

RAPORT FINAL AUDITIMI

Për auditimin e kombinuar në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrin e Kukullave

I. Përmbledhje ekzekutive

Subjekt i vlerësimit të këtij auditimi është veprimtaria menaxhuese dhe funksionimi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas sistemeve të identifikuara për auditim në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrin e Kukullave.

Ky vlerësim u bazua në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; si dhe Programin e Angazhimit të Auditimit miratuar me shkresën 3967/2 prot., date 7.10.2020.

Objektivat e vendosura nga grupi i auditimit lidhur me këtë vlerësim janë:

- Auditimi i sistemit të menaxhimit buxhetor; sistemit të pagave dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; sistemit të prokurimeve të fondeve publike; sistemit të kontabilitetit e raportimit financiar dhe sistemit të menaxhimit të aktiveve; sistemit të projekteve artistike, për periudhën Prill 2017- Shtator 2020, për të vlerësuar saktësinë e regjistrimeve financiare si dhe kryerjen e veprimeve në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjetjet dhe konkluzionet

Progresi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit
<p>Referuar përfundimeve të angazhimit të auditimit”, me gjetjet kryesore të auditimit, janë dërguar edhe 3 (tre) rekomandime të përcaktuara për zbatim. Nga auditimi rezultoi se janë zbatuar 2 dy rekomandime dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim-nuk ka përfunduar procedura e ankandit të automjetit.</p> <p style="text-align: center;">Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.1 të Raportit.</p>
Krijimi i të ardhurave dytësor dhe vlerësimi i monitorimit të kontratave të qirave
<ul style="list-style-type: none">▪ Një prej burimeve të të ardhurave, përveç shitjes së biletave, është dhënia në përdorim e sallës së teatrit me kohë të kufizuar. Për ofrimin e këtij shërbimi është përcaktuar tarifa 15 000 lekë/orë, ndërkohë që kjo tarifë nuk është caktuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me propozim të Ministrit të Kulturës. Ofrimi i këtij shërbimi nuk është dokumentuar nëpërmjet një kontrate qiraje, midis qiradhënësit (Drejtori i QKKF & Teatri i Kukullave) dhe qiramarrësit (subjekti privat/shtetëror), në të cilën ndër të tjera duhet të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet midis palëve.▪ Në drejtim të vlerësimit të monitorimit të kontratave të qirave, gjatë auditimit të kontratës 1 vjeçare me subjektin “A...A.”, rezultoi se marrja dhe lënia e ambjenteve nuk është respektuar detyrimet ligjore dhe kontraktuale, sepse nuk është bërë dorëzimi dhe marrja në

dokumentuar me procesverbal, sipas gentplanit përkatës. Në procesverbal duhet të përshkruhet qartë gjendja fizike e pronës, dhe shoqërohet me pamje fotografike të çastit. Subjekti “A... A” nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratë lidhur me afatin e shlyerjes së qirasë. Pavarësisht se nga ana e institucionit në mënyrë të vazhdueshme janë bërë njoftime për shlyerjen e detyrimeve kontraktuale, nuk është marrë asnjë masë për ndërprerjen e kësaj marrëdhënieje kontraktuale.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.2 të Raportit.

Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore

- Procedurat e marrjes në punë nuk kanë siguruar konkurrencë dhe transparencë të plotë, nëpërmjet shpalljes në Buletinin e Njoftimeve Publike apo në faqen zyrtare të institucionit; si dhe duke përcaktuar kriteret e vlerësimit që duhet të aplikohen gjatë shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve të interesuar.
- Nuk është kryer vlerësimi objektiv vjetor i performancës së punonjësve mbi bazën e objektivave individuale vjetore; për rrjedhojë nuk janë identifikuar nevojat për trajnime për punonjësit (në rast se konstatohet mangësi); por edhe ne mungesën e motivimit të punonjësve, në rast të moskonstatimit të mangësive.
- Gjatë lidhjes së kontratës individuale të punës nuk janë respektuar afatet sipas përcaktimit në Kodin e Punës.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.3 të Raportit.

Prokurimet

- Gjatë auditimit të prokurimit me objekt “Blerje shërbim transporti” për vitet 2017-2018 u konstatua se komisioni i hartimit të kriterëve të veçanta nuk ka argumentuar dhe dokumentuar specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të pranimit nga AK. Anëtarët e komisionit nuk kanë nënshkruar një deklaratë konflikti interesi. Në ftesën për oferte janë përcaktuar kriteret diskriminues që kufizon konkurrencën (vitet 2017-2018). Por për periudhën 2019-2020 sistemi është përmirësuar; komisioni ka reflektuar dhe kriteret janë vendosur në përputhje me udhëzimet e APP-së; anëtarët e komisionit kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit.
- Gjatë auditimit të prokurimit me objekt “Blerje, shërbim Akomodim + ushqim (Mëngjes + Drekë +Darkë)” për vitin 2017 u konstatua se janë realizuar disa procedura me këtë objektë prokurimi dhe të gjitha procedurat janë realizuar me procesverbal të rasteve të emergjencës. E gjithë procedura e prokurimit nuk është parashikuar në Regjistrat e parashikimit të prokurimit publik, për vitin, 2017, fondi është copëzuar, procedurat nuk janë realizuar në përputhje me ligjin, rregullat dhe udhëzimet e prokurimeve prokurimeve. Dokumentacioni në shumicën e rasteve administrohet i pa firmosur dhe i pa protokolluar.
- Nga auditimi i prokurimeve të përzgjedhura për auditim për vitin 2018 u konstatua se komisioni i hartimit të kriterëve të veçanta nuk ka argumentuar dhe dokumentuar specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të pranimit nga AK. Në asnjë rast nuk është dokumentuar terheqja e operatorit dhe kalimi i operatorit nga i pari tek i dyti. Praktikrat e procedurave të prokurimit nuk janë të protokolluara. Autoriteti Kontraktor nuk ka

dokumentuar verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomike, të shpallur fitues.

- Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit të përzgjedhura për periudhën 2019-2020 u konstatua se komisioni në datën dhe orën e hapjes së ofertave, nuk ka hartuar procesverbal për hapjen dhe vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; nuk kanë nënshkruar dokumentacionin e printuar nga sistemi. Praktika e procedurave të prokurimit për vitin 2019 nuk është e protokolluar; por gjatë vitit 2020 ka gjetur zbatim.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.4 të Raportit.

Pagesat e dietave

- Në dy raste të likuidimit të dietave të punonjësve gjatë vitit 2017, u konstatua mungesë e dokumentave justifikuese lidhur me këto shpenzime; pra nuk gjenden as bileta transporti dhe as faturë tatimore e thjeshtë apo me tvsh, e shoqëruar me faturë të printuar nga kasa fiskale. Shuma e likuiduar pa dokumenta justifikuese kundrejt 13 punonjësve është 45 630 lekë gjithsej.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.5 të Raportit.

Sistemi i kontabilitetit

- Nga verifikimi i bilancit për periudhën e audituar rezulton se llogaria 468-debitorë të ndryshëm, në bilancin e vitit 2017 paraqitet në shumën 386 070 lekë; ndërsa në bilancin e vitit 2018 dhe vitit 2019 paraqitet në shumën 528 550 lekë. Detyrimet e punonjësve kundrejt institucionit kanë lindur që prej vitit 2012. Shuma në ngarkim të ish punonjësve debitorë ndaj institucionit është pa shpresë arkëtimi, sepse mos veprimi në kohën e duhur dhe sipas procedurave ligjore ka probabilitet të lartë që institucioni të humbasë këtë të drejtë duke i'u referuar kohës kur ka lindur kjo e drejtë.
- Pasqyrimi i llogarisë 218-inventar ekonomik, por edhe i llogarisë 214 (instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune) nuk është i saktë, sepse aktivet që i përkasin llogarisë 218 janë pasqyruar në llogarinë 214. Për rrjedhojë edhe vlera e amortizimit të këtyre aktive dhe vlera e amortizimit të akumuluar në bilanc nuk është e saktë.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.6 të Raportit

Projektet artistike

- Për periudhën e audituar rezulton se nuk është miratuar gjurma e auditimit mbi projektet artistike, pra: nuk ka rregulla të miratuara për planifikimin, aplikimin dhe monitorimin e projekteve artistike. Në asnjë rast dorëzimi i dosjeve të projekteve nuk është administruar nëpërmjet protokollit. Meqenëse nuk janë përcaktuar kritere për vlerësimin e projekteve, nuk është dokumentuar në asnjë rast ngritja e komisionit për vlerësimin e dojeve të dorëzuara, si dhe vendimi për përzgjedhjen e projektit fitues.
Pra, mungesa e gjurmës së auditimit ka ndikuar në mungesën e një procedure të hapur, duke shmangur konkurrencën.
- Bordi Artistik nuk ka miratuar rregulloren e funksionimit; e cila propozohet nga titullari i institucionit;
Nuk është dokumentuar me procesverbal të veçante mbledhja e BA, proces verbal i cili duhet të protokollohet. Në asnjë rast anëtarët e BA nuk kanë deklaruar konfliktin e interesit; Bordi

Artistik nuk ka miratuar kriteret e shpërblimit të cilësisë artistike për çdo vepër që do të realizohet.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.7 të Raportit

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit

- Institucioni nuk ka një statut të përditësuar; statuti me të cilin funksionon është protokolluar me nr.186 prot., datë 18.10.2012 dhe rezulton të jetë dërguar me e-mail nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
Nuk është hartuar e miratuar gjurma e auditimit për projektet artistike, përcaktuar edhe në përshkrimin e gjetjes me të njëjtin titull;
Nuk është propozuar rregullore e funksionimit të bordit artistik dhe për pasojë nuk është miratuar kjo rregullore.
Nuk ka burime njerëzore të mjaftueshme, konkretisht mungon në organikë emërtesa specialist jurist dhe specialist arkiv-protokoll; pozicione pune mjaft të domosdoshme në këtë institucion;
- Gjetjet gjatë vlerësimit të këtij sistemi, por edhe të sistemeve të përfshira në programin e auditimit të këtij angazhimi, konkudojnë se në këtë institucion duhet të përmirësohen më tej mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit si dhe monitorimi.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.9 të Raportit

Rekomandimet kryesore

Bazuar ne gjetjet e përmendura në çështjen nr.IV të këtij Raporti, rekomandimet kryesore konsistojnë ne:

- Përlllogaritjen e kostos së tarifës së dhënies me qira të sallës së teatrit; Marrjen e masave të nevojshme në rast të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale të shërbimit të dhënies me qira;
- Sigurimin e konkurrencës dhe transparencës së plotë në procedurat e punësimit;
- Arkëtimin e dietave nga 13 punonjësit në shumën 45 630 lekë gjithsej, të cilat janë likuiduar pa dokumenta justifikuese;
- Trajnimin e punonjësve të këtij institucioni lidhur me procedurat e prokurimit publik;
- Hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit lidhur me projektet artistike, për të siguruar transparencë dhe konkurrencë gjatë këtij procesi; miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit Artistik;
- Përditësimin e statutit të QKKF&TK;
- Sistemin e llogarive kontabël.